

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E PERFORMANCËS	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	7
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	8 – 15

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe ortakun e Shoqërisë "Tirana DC" sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë "Tirana DC" sh.a (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2020, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2020, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 4 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe për arsyen e aplikimit të parimit të vijueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare (vazhdim)

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare (vazhdim)

- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

mazars

Emin Durraku Shtet, Binjakët Bldd.,
No. 5, 1013, Tiranë, Albania
NUTS/ K32123006W

24 Mars 2021

Diana Ylli (Golemi)

Auditues Ligjor

Tirana DC sh.a

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 dhjetor 2020

	Shënime	31 dhjetor 2020
AKTIVE		
Aktive afatshkurtra		
Mjete monetare	5	49,278,269
Totali i aktiveve afatshkurtra		49,278,269
 Aktivet afatgjata		
Aktive afatgjata materiale		-
Totali i aktiveve afatgjata		-
Totali i aktiveve		49,278,269
 DETYRIMET		
Detyrime afatshkurtra		
Detyrime tatimore	6	632,580
Të tjera detyrime	7	1,613,325
Totali i detyrimeve afatshkurtra		2,245,905
 Detyrime afatgjata		
Totali i detyrimeve afatgjata		-
Totali i detyrimeve		2,245,905
 Kapitali		
Kapitali i nënshkruar		50,000,000
Fitimi i ushtrimit		(2,967,636)
Totali i kapitalit	8	47,032,364
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		49,278,269

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës

Për periudhën 3 nëntor 2020 deri më 31 dhjetor 2020

	Shënime	Për periudhën nga 3 nëntor deri më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit		-
Total të ardhura		-
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		-
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme		
2) Të tjera shpenzime		
Shpenzime të personelit	9	(2,953,930)
1) Paga dhe shpërblime		(2,408,633)
2) Shpenzime përfaqësimi		(195,000)
3) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(350,297)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	10	(13,706)
Shpenzime financiare		-
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		-
2) Shpenzime të tjera financiare		-
Fitimi/humbja para tatimit		(2,967,636)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-
Fitimi/humbja e vitit		(2,967,636)
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(2,967,636)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Tirana DC sh.a

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Më 31 dhjetor 2020

Pozicioni financiar më 3 nëntor 2020	Kapitali i nënshkruar	Fitim / Humbja e vitit	Totali
	-	-	-
Fitim/humbja e vitit			
Emetim i kapitalit	50,000,000	(2,967,636)	(2,967,636)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	50,000,000	(2,967,636)	47,032,364

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë aprovuar nga administratori i Tirana DC më 18/03/2021 dhe janë firmosur si më poshtë.


Z. Redi Molla
Administrator


Collins Haxhiy

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për periudhën 3 nëntor 2020 deri më 31 dhjetor 2020

	Shënime	Për periudhën nga 3 nëntor deri më 31 dhjetor 2020
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit		(2,967,636)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare		-
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		-
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
		1,601,925
Rritje/(rënie) në detyrimet për punonjësve		
Rritje/(rënie) në detyrime tatimore		632,580
Rritje/(rënie) në detyrime të tjera		11,400
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		(721,731)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		-
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		50,000,000
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		50,000,000
		49,278,269
Ndryshimi neto i mjeteve monetare		
Mjetet monetare në fillim të periudhës		-
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit		-
Mjetet monetare në fund të periudhës	4	49,278,269

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Tirana DC sh.a. (referuar si "Shoqëria") është e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më datë 3 nëntor 2020. Bazuar në dokumentat e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 50,000,000 Lekë. Shoqëria është e regjistruar me Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë me NIPT M02303027S.

Aktiviteti i Shoqërisë konsiston në projektim, ndërtim, rindërtim, zbatim, kolaudim të ndërtimeve të të gjitha llojeve, duke përfshirë këtu, por pa u kufizuar në ndërtime me qëllim banimi, ndërtime me karakter social, kulturor, industrial, publik kur është rasti, si dhe ndërtime të tjera me karakter tregtar. Kryerja e investimeve duke mobilizuar kapital shtetëror dhe/ose privat vendas apo të huaj. Ndërtimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e veprave, fasadave, ndërtesave publike dhe private si dhe menaxhimin e shërbimeve, mallrave dhe punimeve publike për realizimin e tyre; Kryerjen e punimeve për restaurimin e ndërtesave artistike, kulturore e publike në administrim publik; Kërkime, studime, planifikim, projektim dhe drejtim të punimeve në sektorin e ndërtimit dhe inxhinierisë në përgjithësi, përfshirë të gjitha disiplinat dhe instrumentet që kanë lidhje me këto fusha; Këshillimi dhe planifikimi në sektorin e shërbimeve publike dhe/ose private; Realizimin, krijimin, zhvillimin, menaxhimin dhe shitjen e projekteve, pasurive, mallrave dhe shërbimeve, për arritjen e qëllimeve dhe objektivave tregtare në përputhje me këtë statut dhe me aktet ligjore në fuqi; Blerje, shitje, administrim, të materialeve dhe të çdo lloj pasurie të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, në zbatim e në përputhje me aktivitetin e shoqërisë.

Shoqëria ka përfaqësues ligjor Z. Redi Molla.

Adresa aktuale e Shoqërisë është: Njesia Administrative nr.9, Rruga Bardhok Biba, nr. Pasurie 6/377.
Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2020 është 19.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 datë 30 maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në periudhën e paraqitur në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shoqëria nuk ka kryer transaksione në monedhë të huaj përgjatë vitit 2020.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2020
Euro/LEK	123.7
USD/LEK	100.84

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Shoqëria nuk ka patur llogari të arkëtueshme përgjatë vitit 2020.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal. Shoqëria nuk ka patur hua të dhëna apo të marra përgjatë vitit 2020.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Shoqëria nuk ka gjeneruar të ardhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2020.

3.4. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.5. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.6. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.7. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15%.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.9. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.10. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.11. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Gjykime mbi efektet pandemisë në parimin e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

5. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2020</u>
Mjete monetare në bankë	<u>49,278,269</u>
Llogari rrjedhëse	49,278,269
Mjete monetare në arkë	-
	<u><u>49,278,269</u></u>

6. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>
Detyrimi për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore	432,137
Detyrimi për Tatimin mbi të Ardhurat Personale	171,193
Detyrimi për Tatimin në burim	29,250
	<u><u>632,580</u></u>

7. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>
Detyrime për Pagën Neto	1,601,925
Bashkia Tirane / Taksa	11,400
	<u><u>1,613,325</u></u>

8. Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 50.000.000 Lek i zotëruar 100% nga Bashkia Tiranë, i cili më 31 dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>			
	Kuota	Vlera nominale	Kapitali i nënshkruar	%
Bashkia Tiranë	1,000	50,000	50,000,000	100%
	1,000		50,000,000	100%

Shoqëria ka humbje më 31 dhjetor 2020 në vlerën (2,967,636) Lek.

9. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për periudhën nga 3 nëntor 2020 deri më 31 dhjetor 2020:

	Për periudhën nga 3 nëntor deri më 31 dhjetor 2020
Shpenzim paga	2,272,991
Shpenzim paga - ushqim	135,642
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	350,297
Shpenzime për bordin drejtues	195,000
	2,953,930

Numri i punonjësve gjatë dhjetorit 2020 është 19 punonjës.

10. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin shpenzimet bankare dhe shpenzimet për taksat për periudhën nga 3 nëntor 2020 deri më 31 dhjetor 2020:

	Për periudhën nga 3 nëntor deri më 31 dhjetor 2020
Shpenzime taksa vjetore	11,400
Shpenzime bankare	2,306
	13,706

11. Ngjarjet pas datës së bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas dates së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.

Emri I shoqerise: Tirana DC sh.a.
 Adresa: TIRANE Njesia Administrative nr.9, Rrugë Bardhok Biba, Nr.pasurise 6/377
 NIPT/NUIS: M02303027S
 Viti 2020

Aktivët Afatgjatë Materialë me Vlerë fillestare 2020

Nr	Sasia	Gjendja 03.11.2020	Shtesa	Pakesime	Gjendja 31.12.2020
1	Mobilje dhe orëndi	-			-
2	Pajisje informatike				-
3	Permiresim ne qeramarje				-
4	Te tjera				-
Totali		-	-	-	-

Amortizim kontabel Aktivë Afatgjatë Materialë 2020

Nr	Sasia	Gjendja 03.11.2020	Shtesa	Pakesime	Gjendja 31.12.2020
1	Mobilje dhe orëndi				-
2	Pajisje informatike				-
3	Permiresim ne qeramarje				-
4	Te tjera				-
Totali		-	-	-	-

Vlera kontabel neto Aktivë Afatgjatë Materialë 2020

Nr	Sasia	Gjendja 03.11.2020	Shtesa	Pakesime	Gjendja 31.12.2020
1	Mobilje dhe orëndi	-	-	-	-
2	Pajisje informatike	-	-	-	-
3	Permiresim ne qeramarje	-	-	-	-
4	Te tjera	-	-	-	-
Totali		-	-	-	-

Administratori
 Redi Molla



Colina

Harbu
 off

Emri I shoqerise: Tirana DC sh.a.
 Adresa: TIRANE Njesia Administrative nr.9, RrugëBardhok Biba, Nr.pasurise 6/377
 NIPT/NUIS: M02303027S
 Viti 2020

Aktivët Afatgjatë jo materiale 2020

Nr	Sasia	Gjendja 03.11.2020	Shtesa	Pakesime	Gjendja 31.12.2020
1	Programë kompjuterike		-	-	-
Totali		-	-	-	-

Amortizim kontabel I aktiveve jo materiale 2020

Nr	Sasia	Gjendja 03.11.2020	Shtesa	Pakesime	Gjendja 31.12.2020
1	Programë kompjuterike			-	-
Totali		-	-	-	-

Vlera kontabel neto e aktiveve jo materiale 2020

Nr	Sasia	Gjendja 03.11.2020	Shtesa	Pakesime	Gjendja 31.12.2020
1	Programë kompjuterike	-	-	-	-
Totali		-	-	-	-

Administratori
 Redi Molla



Edlira Hoxha
 01/11

Emri I shqerise: Tirana DC sh.a.
Adresa: TIRANE Njesia Administrative nr.9, Rrugabardhok Biba, Nr.pasurise 6/377
NIPT/NUIS: M02303027S
Viti 2020

Inventari I mjeteve te transportit ne prone

Per analize te inventarit dhe materialeve sipas politikave fiskale te aplikueshme ne republiken e Shqiperise,
ju lutem referojuni tabeles se meposhtme:

Nr	Artikull	Njesia	Sasia	Kosto	Monedha ne lek	
					Vlera	
1						-
2						-
3						-
4						-
5						-
6						-
Totali						-

Shenim: Shqeria nuk ka ne prone si mjete transporti.

Administratori
Redi Molla



Emri I shqerise: Tirana DC sh.a.

Adresa: TIRANE Njesia Administrative nr.9, Rrugabardhok Biba, Nr.pasurise 6/377

NIPT/NUIS: M02303027S

Viti 2020

Giendia e inventarit dhe mallrave me 31.12.2020

Per analize te inventarit dhe materialeve sipas politikave fiskale te aplikueshme ne republiken e Shqiperise
ju lutem referojuni tabelës se mëposhtme:

Nr	Artikull	Njesia	Sasia	Kosto	Monedha ne lek	
					Vlera	
1					-	-
2					-	-
3					-	-
4					-	-
5					-	-
6					-	-
Totali					-	-

Shenim: Shqerieria ne aktivitetin e saj nuk ka perdorur mallra dhe materiale

Administratori

Rendi Molla



Edlira